



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZLAnr.200/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Skender Çoçaj kryesues, Arsim Hamzaj dhe Kymete Kicaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e [REDAKTUAR], komuna Ferizaj, paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me seli në Prishtinë, me objekt të çështjes, ndërrimi i vend votimit në ditën e votimit për Zgjedhjet Lokale, të mbajtura me datë 12.10.2025, në seancën e panelit, të mbajtur me datë 15.10.2025, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet e pabazuar ankesa me numër ZL.A.nr 200/2025 e datës 12.10.2025, e paraqitur nga [REDAKTUAR] komuna Ferizaj, paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me seli në Prishtinë.

A r s y e t i m

Me datë 12.10.2025, [REDAKTUAR] me vendbanim në Ferizaj, ka paraqitur ankesë në PZAP, me të cilën deklaron se si qytetar nga Ferizaj i është ndërruar qendra e votimit në tjetër Komunë pa kurrfarë njoftimi dhe për këtë arsye i është ndaluar e drejta e votimit.

Në përgjigje në ankesë, KQZ-ja sqaron se bazuar në nenin 8 paragrafi 1, të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, i cili parasheh se KQZ-ja mban Listën e votuesve dhe siguron që e njëjta bazohet në të dhënat e sakta, të përditësuara dhe më të fundit të Regjistrit Qendror Civil dhe e cila në mënyrë sistematike largon nga lista personat e vdekur dhe personat që kanë hequr dorë nga shtetësia. Kjo listë përmban: ekstraktin më të vonë në dispozicion nga Regjistri Qendror Civil i të gjithë votuesve me të drejtë vote të cilët janë regjistruar si shtetas të Kosovës sipas Ligjit për shtetësinë dhe paragrafi 2 i nenit 8 i cili parasheh se lista e votuesve nga paragrafi 1 i këtij neni, përmban informatat personale të ofruara për secilin votues siç janë: emri, mbiemri, data e lindjes, adresa dhe Qendra e Votimit ku ai/ajo është caktuar për të votuar. Bazuar në këto dispozita, KQZ njofton se Lista e votuesve përmban të gjitha informacionet e nevojshme, ndër të tjera edhe Qendrën e Votimit

në të cilën votuesi është caktuar për të votuar. Ndërrimi i Qendrës së Votimit bazohet në përditësimet e sakta të Regjistrit Qendror Civil, andaj parashtruesi së ankesës i është ndryshuar Qendra e Votimit, kjo ka ardhur si rezultat i të dhënave të përditësuara të Regjistrit Civil. Tutje, KQZ sqaron se bazuar në nenin 83 të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme parasheh: *“Mbështetur në rekomandimet e Komisionit Komunal të Zgjedhjeve (KKZ), KQZ-ja, përmes Sekretariatit të KQZ-së, jo më vonë se dyzet (40) ditë para zgjedhjeve, i publikon lokacionet e sakta të të gjitha QV-ve. Secilit votues të regjistruar i caktohet Qendra e Votimit që është lokacioni ku emri i tij/saj shfaqet në Listën Përfundimtare të Votuesve të përdorur gjatë mbajtjes së votimit në ditën e zgjedhjeve. Sa më shumë që të jetë e mundur asnjë votues nuk duhet të udhëtojë më tepër se tre (3) km deri në vendin e tij apo saj të votimit. Ndryshimet pasuese të lokacioneve të QV-ve lejohen në rastet e force madhore, ose arsye tjera objektive dhe të paparashikueshme që do të bënin QV-në të papërshtatshme për qëllime të votimit. Sekretariati i KQZ-së e informon menjëherë KQZ-në për këto ndryshime. Nëse lokacioni i QV-së është ndryshuar, KKZ-ja i njofton votuesit për ndryshimin përmes burimeve në dispozicion të mediave lokale. Si shtesë, KKZ-ja vendos lajmërim në lokacionin origjinal të QV-së duke këshilluar votuesit për lokacionin e ri të QV-së”* Përveç sqarimeve të lartcekura, KQZ shton se vazhdimisht ka bërë fushatë informuese, përmes mediave, rrjete sociale dhe mesazheve telefonike për verifikimin e Qendrës së Votimit për votuesit e Republikës së Kosovës dhe pala ankuese ka pasur të drejtën e ndërrimit të Qendrës së votimit deri me datën 29.08.2025 përmes linkut qv.kqz-ks.org. Sipas KQZ-së pala ankuese i është ndryshuar QV sipas kërkesës së znj. Festina Sadiku (familjare e palës) e cila ka bërë kërkesë për ndryshim të adresës më datën 26.08.2025, në zyrat e Gjendjes Civile, e cila kërkesë është aprovuar nga gjendja civile po atë ditë.

PZAP, pasi që shqyrtoj dhe vlerësoi ankesën gjeti se:

Ankesa është e pa bazuar.

Paneli, pas shqyrtimit paraprak të ankesës, ka gjetur se ankesa e parashtruar nga [REDAKTUAR] për shkak të ndërrimit të vendvotimit është e pabazuar, për faktin se për ankuesen ka parashtruar kërkesë për ndryshim të vendvotimit familjarja e saj Festina Sadiku, e cila kërkesë është aprovuar nga gjendja civile po në datën e njëjtë të parashtrimit të kërkesës.

Paneli ka vlerësuar se në baze të përgjigjes së dhënë nga KQZ është vërtetuar se KQZ në vazhdimësi kanë bërë fushatë informuese përmes rrjeteve sociale dhe mesazheve telefonike për verifikim të Qendrës së Votimit për votuesit e Republikës së Kosovës, andaj kjo jep të kuptohet se parashtruesja e ankesës ka qenë në mundësi për tu informuar për ndryshim të vendvotimit ashtu siç ka kërkuar në baze të kërkesës së parashtruar për ndryshim të vendvotimit.

Në këtë kuptim nga shqyrtimi i shkresave të lëndës rezulton se certifikimi i listës përfundimtare të votuesve është bërë më datën 06 shtator 2025, që do të thotë se Vendimi i KQZ-së për Certifikimin e Listës së Votuesve, Nr. 2350-2025 është publikuar më datën 06.09.2025, dhe kundër këtij vendimi ka pasur afat ankese 48 orë nga marrja e vendimit,

Nga shqyrtimi i shkresave të lëndës, paneli ka gjetur se ankesa është pabazuar për faktin se konsiderohet lëshim i vet ankueses që nuk ka shfrytëzuar mundësinë që të informohet me

pare për ndryshimin e vendvotimit, ashtu siç ka kërkuar vet ankuesja në bazë të kërkesës për ndryshim të Qendrës së Votimit

Prandaj, nga arsyet e paraqitura më lart dhe në pajtim me nenin Paneli gjeti se ankesa e parashtruar është e pabazuar, dhe duke u bazuar në nenin 118 paragraf 1 të LZP-së, Paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
ZL-Anr.200/2025 datë 15.10.2025



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi